



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 13 datë 24.02.2026

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NGASTRAVE PYJORE DHE KULLUSORE TË  
GATSHME PËR TU DHËNË NË PËRDORIM PËR KULLOTË PËR VITET 2026-2027**

Kryetari i Bashkisë, pasi shqyrtoi relacionin “Për miratimin e listës së ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë për vitet 2026-2027” të paraqitur nga Sektori i Pyejeve dhe Kullotave, bazuar në Ligjin 139/2015 për “Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji nr.8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, Ligji nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligji nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar; VKM nr.433 date 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive” ndryshuar me VKM 398 datë 13.05.2020, Udhëzimin nr.2 datë 20.07.2016 i Ministrisë së Mjedisit dhe ligjin “Për fondin kullor”:

Me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë, për vitet 2026-2027 sipas listës bashkëlidhur.
2. Dhënia në përdorim e pasurisë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të kryhet sipas rregullave dhe procedurave të shpalljes të përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 20.07.2016 i Ministrisë së Mjedisit dhe ligjin “Për fondin kullor”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyejeve dhe Kullotave në Bashkinë Përmet.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Aleks TANE

KRYETAR  
Anila DHIMITRI

